

Banka e Shqipërisë

ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË

T1 - 2022

Enian Çela

Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

KORRIK 2022

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

I.	ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE	3
II.	LLOGARIA KORRENTE	4
III.	LLOGARIA KAPITALE	8
IV.	LLOGARIA FINANCIARE	8
V.	PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT	10

I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE

Të dhënat e Bilancit të Pagesave në tremujorin e parë të vitit 2022 pasqyruan një përmirësim të përgjithshëm të deficitit korrent. Deficiti tregtar është zvogëluar, i ndikuar më së shumti nga rritja e lartë e flukseve turistike. Gjithashtu, vihet re një rritje e lartë e remitancave dhe hyrje të shtuara të Investimeve të Huaja Direkte.

Deficiti i llogarisë korrente shënoi 232.8 milionë euro¹, duke u ngushtuar me rreth 21.8% në terma vjetorë. Deficiti vlerësohet në 5.8% ndaj PBB-së, ose 3.0 pikë përqindjeje më i ulët krahasuar me një vit më parë. Rritja e lartë e eksporteve (58.8%) dhe më konkretisht ajo e shërbimeve (47.9%) ka dhënë ndikimin kryesor në këtë drejtim. Flukset hyrëse të turizmit janë rritur me 70.5% në terma vjetorë, duke tejkaluar tashmë nivelet para pandemisë (tremujori i parë i vitit 2019). Gjithashtu, kontribute pozitive kanë buruar edhe nga rritja e eksportit të mallrave me 82.9%, e cila është ndikuar më së shumti nga rritja e çmimeve ndërkombëtare. Këto të fundit arritën nivele të larta historike pas sulmit rus në Ukrainë.

Sikurse eksportet, një rritje të lartë shënuan edhe importet, me 32.1%. Rritja e tyre u drejtua nga rritja e importit të mallrave me 27.8%. Edhe në këtë rast, vlerësohet që ndikimet kryesore të kenë ardhur nga rritja e çmimeve ndërkombëtare. Përveç mallrave, rritje e lartë vjetore vihet re edhe në rastin e shërbimeve (46.0%), të ndikuara kryesisht nga turizmi dalës.


Llogaria e të ardhurave parësore shënoi një deficit prej 65.6 milionë eurosh, në nivele pak a shumë të ngjashme me një vit më parë. Kontributet e rritura hyrëse nga të ardhurat nga puna janë kompensuar plotësisht nga ato dalëse të investimeve. Në rastin e të ardhurave dytësore, teprica pozitive është pakësuar me 1.5%, si pasojë e rënies së flukseve të "Qeverisë së Përgjithshme" dhe të ardhurave të tjera private. Ndërkohë, remitanca u rritën me 9.2% në terma vjetorë, nivele të ngjashme me ato të tremujorit të kaluar.

Në llogarinë financiare, janë regjistruar detyrime neto në vlerën 303.5 milionë euro. Flukset hyrëse të investimeve direkte u rritën me rreth 16.4%. Stoku i rezervës në fund të tremujorit të parë të vitit 2022, është në gjendje të mbulojë 8.2 muaj import mallrash dhe shërbimesh ose 394% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

¹ Në fund të materialit gjendet një tabelë përmbledhëse për zhvillimet kryesore të Bilancit të Pagesave gjatë periudhave të fundit, përfshirë tremujorin në analizë.

II. LLOGARIA KORRENTE

Deficiti i llogarisë korrente shënoi 232.8 milionë euro në tremujorin e parë të vitit 2022, duke u pakësuar me rreth 21.8% në terma vjetorë. Deficiti u vlerësua në nivelin 5.8% të PBB-së ose rreth 3.0 pikë përqindje më i ulët se i njëjti tremujor i një viti më parë. Faktor themelor në këtë ecuri ka qenë rritja e shpejtë e eksporteve e ndikuar nga flukset e shërbimeve.




Rritja e eksporteve shënoi 58.8%, e nxitur nga zgjerimi i eksportit të shërbimeve me 47.9%. Këtu vihet re në mënyrë të veçantë kontributi i lartë i flukseve hyrëse të turizmit. Rritja vjetore e tyre shënoi 70.5% dhe niveli i tyre qëndron 17.4% mbi nivelin e flukseve hyrëse të turizmit para pandemisë. Gjatë vitit të kaluar, pavarësisht rritjes së lartë vjetore, flukset e turizmit qëndronin ende lehtësisht nën nivelet e vitit 2019. **Paralelisht me ecurinë e shërbimeve, edhe eksportet e mallrave shfaqën rritje të lartë (82.9%).** Rritja është dukshëm më e lartë nëse krahasohet me gjysmën e dytë të vitit të kaluar kur mbizotëronte edhe një efekt i fortë baze nga pandemia. Një pjesë e konsiderueshme e efektit rritës buron nga rritja e lartë e çmimeve ndërkombëtare të mallrave, e cilave u përshpejtua pas sulmit rus në Ukrainë.

Importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 32.1% krahasuar me një vit më parë. Rritja është përcaktuar nga zgjerimi i importit të mallrave me 27.8%, i cili - sikurse në rastin e eksporteve – është ndikuar nga rritja e çmimeve. Në rritje ka ardhur edhe importi i shërbimeve me 46.0%. Shërbimet dalëse të turizmit kanë dhënë kontributin kryesor në këtë drejtim. Edhe këto flukse janë rimëkëmbur përtej nivele të pandemisë, duke përfituar nga eliminimi thuajse i plotë i pengesave në udhëtim për qytetarët shqiptarë. Kjo nuk ndodhte gjatë vitit të kaluar, kur këto flukse, ndryshe nga ato eksportuese, qëndronin dukshëm nën nivelet e parapandemisë, për shkak të asimetrisë në heqjen e kufizimeve për të huajt në Shqipëri krahasuar me shqiptarët për jashtë vendit.

Deficiti i përgjithshëm tregtar në mallra dhe shërbime u ngushtua me rreth 14.9%, për shkak të mbizotërimit të efektit eksportues. Deficiti tregtar qëndron në nivelin 10.3% ndaj PBB-së, me pakësim 4.1% krahasuar me një vit më parë.


Grafik 2. Zërat kryesorë në llogarinë e shërbimeve (flukse neto në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të ardhurat parësore shënuan një deficit prej 65.6 milionë eurosh - një nivel i ngjashëm me një vit më parë. Vihet re një rimëkëmbje e shpejtë e të ardhurave hyrëse nga puna, në reflektim edhe të eliminimit gradual të masave kufizuese ndaj lëvizjes së punonjësve vendas sezonalë. Nga ana tjetër, flukset dalëse të të ardhurave nga investimet (kryesisht ato direkte) vazhdojnë të zgjerohen, duke kompensuar efektin e flukseve hyrëse nga puna.


Grafik 3. Bilanci i të ardhurave parësorë (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe të ardhurat nga investimet direkte (flukse neto, në milionë euro, djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Suficiti i nënlllogarisë së të ardhurave dytësore u ngushtua me rreth 1.5% në terma vjetorë, ndikuar nga flukset e "Qeverisë së Përgjithshme" dhe të ardhurat e tjera private. **Nga ana tjetër, flukset hyrëse të remitancave vazhdojnë të ndjekin një trajektore rritëse.** Rritja vjetore e tyre shënoi 9.2%, në nivele të ngjashme me tremujorin e mëparshëm.

Grafik 4. Dërgesat e emigrantëve (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe financimi i deficitit tregtar të mallrave nga të ardhurat neto parësore, dytësore dhe nga shërbimet (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


HAPËSIRË INFORMUESE. ZHVILLIMET NË KURSIMET DHE INVESTIMET KOMBËTARE

Ngushtimi i deficitit korrent në terma vjetorë është shkaktuar kryesisht nga rritja e kursimeve kombëtare. Rritja e tyre reflekton zgjerimin e kursimeve publike, ndërsa ato private vlerësohen në rënie. Në kahun e investimeve, vlerësohet një rritje e investimeve private, por një rënie e atyre publike.

Hendeku kursime-investime i sektorit privat u vlerësua në -10.4 % të PBB-së, rreth 3.6 pikë përqindje më i thellë krahasuar me një vit më parë. Raporti i investimeve private ndaj PBB-së vlerësohet në nivelin 18.0%, rreth 3.0 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë. Kursimet private ndaj PBB-së vlerësohen në nivelin 7.6%, rreth 0.6 pikë përqindje më të ulëta se një vit më parë.

Hendeku publik vlerësohet në 4.5% ndaj PBB-së, me përmirësim 0.6 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Kursimet publike vlerësohen në nivelin 0.8% ndaj PBB-së, me një rritje 4.4 pikë përqindje në terma vjetorë. Investimet publike u vlerësuan në 2.3% ndaj PBB-së, rreth 2.3 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Rritja e kursimeve publike ka qenë përcaktuese në ngushtimin e hendekut përkatës dhe në ngushtimin e deficitit korrent.

Grafik 5. Kontributi i treguesve të investimeve dhe kursimeve në dinamikën e deficitit (majtas) dhe kontributi i tyre në ndryshimin vjetor të deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT, dhe vlerësime të autorit.


III. LLOGARIA KAPITALE

Teprica pozitive e llogarisë kapitale ishte rreth 9.5 milionë euro, rreth 88.4 milionë euro më e ulët krahasuar me një vit më parë. Kontributet kryesore në këtë ecuri lidhen me “Qeverinë e Përgjithshme”, për shkak të efektit nga “fondet e rindërtimit”. Flukset kapitale neto në këtë llogari vlerësohen në 0.2% ndaj PBB-së.

Në tremujorin e parë të vitit 2022, ekonomia jonë paraqet një pozicion neto huamarrës prej 223.2 milionë eurosh. Ky nivel rezulton 11.8% më i lartë krahasuar me një vit më parë. Efekti përkeqësues në llogarinë kapitale ka tejkaluar atë përmirësues nga llogaria korrente, duke shkaktuar një zgjerim të pozicionit huamarrës neto të jashtëm.

IV. LLOGARIA FINANCIARE


Llogaria financiare regjistroi detyrime neto në vlerën 303.5 milionë euro, me rritje 25.4% në terma vjetorë. Kontributet kryesore të detyrimeve kanë buruar nga Investimet Direkte. **Flukset hyrëse të Investimeve Direkte u rritën me 16.4%**, duke ruajtur normat e larta të shfaqura prej tremujorit të mëparshëm. Rritja e investimeve direkte pasqyroi rritjen e investimeve në “Pasuritë e paluajtshme”, “Industriinë nxjerrëse”, “Energjinë”, “Sektorin financiar dhe të sigurimit” dhe “Industriinë përpunuese”. Flukset totale llogariten në 6.8% ndaj PBB-së, një nivel pothuaj i ngjashëm me një vit më parë.



Në rastin e investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera, vihet re një përkëmbim i mjeteve të “Korporatave depozitëmarrëse”. Kështu, vihet re një pakësim i mjeteve në formën e “Monedhave dhe Depozitave” (Investime të tjera) dhe zgjerim i mjeteve në pothuaj të njëjtën masë në formën e “Detyrimeve


të Borxhit" (Investime të portofolit) dhe "Huasë" (Investime të tjera). Në njëjtën kohë, detyrimet e "Qeverisë së Përgjithshme" janë shtuar për "Huatë" dhe janë pakësuar për "Detyrimet e Borxhit" (Investime portofoli). Në rastin e dytë, bëhet fjalë për kalimin e pronësisë së Eurobondit nga jorzidentët të "Korporatat depozitëmarrëse" vendase. Kjo shënohet si zvogëlim i detyrimit të "Qeverisë së Përgjithshme" ndaj jorzidentëve, ndonëse detyrimi i Eurobondit mbetet i njëjtë. Kundërpartia në këtë rast është pakësim i mjeteve të rezervës.

Grafik 7. Përbërësit e llogarisë financiare (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 8. Raporti i financimit të deficitit korrent prej investimeve direkte neto



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një pakësim të mjeteve të rezervës me 88.9 milionë euro. Në fund të muajit mars 2022, stoku i rezervës valutore vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 8.2 muajve import mallrash dhe shërbimesh ose 394% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto. Së fundi, zëri "gabime dhe harresa neto" rezultoi në një fluks dalës prej 80.3 milionë eurosh, i cili vlerësohet në 2.0% ndaj PBB-së nominale.

Grafik 9. Gabime dhe harresa ndaj PBB-së nominale (% , majtas) dhe ndaj deficitit të llogarisë korrente (% , djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

V. PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT

Profili i financimit të deficitit korrent, përcaktohet nga ecuria e flukseve hyrëse borxhkrijuese, kundrejt flukseve hyrëse joborxhkrijuese². Flukset financiare joborxhkrijuese nga investimet direkte neto dhe nga llogaria kapitale u vlerësuan në nivelin 6.6% ndaj PBB-së nominale. Këto ishin rreth 3.0 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë. Flukset financiare borxhkrijuese u vlerësuan në nivelin -1.0% ndaj PBB-së nominale, rreth 3.7 pikë përqindje më të ulëta krahasuar me një vit më parë.

Grafik 10. Flukset hyrëse financiare borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe financimi në total i deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

² Kjo ndarje shërben për të monitoruar ndikimin që flukset financiare e kapitale kanë në borxhin e jashtëm të vendit. Flukset joborxhkrijuese përfshijnë investimet direkte dhe hyrjet neto të llogarisë kapitale, ndërsa flukset borxhkrijuese përfshijnë investimet e portofolit dhe investimet e tjera neto.

Pasi flukseve valutore neto borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese në tërësi u shtohen edhe gabimet dhe harresat neto, përftohet masa e financimit të përgjithshëm të deficitit korrent. Gjatë tremujorit në analizë, raporti i financimit të llogarisë korrente ishte në nivelin 61.8%, duke u përkthyer në një pakësim të mjeteve të rezervës. Raporti i financimit rezultoi rreth 63.2 pikë përqindje më i ulët krahasuar me një vit më parë, por vlerësohet përsëri mbi nivelin 100% nëse merret si mesatare 4-tremujorësh.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

	T3'20	T4'20	T1'21	T2'21	T3'21	T4'21	T1'22
Llogaria Korrente (në mil euro)	-191.2	-348.7	-297.7	-232.6	-110.5	-545.5	-232.8
vmv (%)	8.3	0.8	26.6	-38.4	-42.2	56.5	-21.8
/ PBB-së (%)	-5.6	-9.7	-8.9	-5.7	-2.8	-13.3	-5.8
Mallra dhe shërbime	-447.4	-582.0	-482.4	-411.2	-352.1	-807.6	-410.5
vmv (%)	17.8	2.2	25.5	-20.5	-21.3	38.8	-14.9
Eksporte, f.o.b.	852.6	831.8	846.0	1179.8	1504.4	1200.7	1343.8
vmv (%)	-36.7	-18.4	-0.2	141.6	76.5	44.3	58.8
Importe, f.o.b.	1299.9	1413.8	1328.4	1590.9	1856.5	2008.3	1754.3
vmv (%)	-24.7	-11.0	7.8	58.3	42.8	42.0	32.1
Udhëtime neto	133.1	96.9	101.4	186.8	384.6	167.2	85.8
Të ardhura parësore	-30.6	-71.4	-62.4	-74.9	-41.8	-31.8	-65.6
Kredi	96.6	90.0	84.1	85.0	105.4	123.0	107.3
Debi	127.3	161.4	146.5	160.0	147.2	154.9	172.9
Të ardhura neto nga Investimet Direkte	-86.7	-112.3	-118.8	-118.6	-120.7	-116.8	-149.3
Të ardhura dytësore	286.9	304.7	247.1	253.5	283.5	293.9	243.3
Kredi	333.5	350.3	286.4	293.8	327.2	336.5	284.1
Debi	46.6	45.5	39.4	40.3	43.8	42.6	40.8
Dërgesa nga emigrantët -neto	197.4	202.7	168.5	171.2	199.3	221.9	184.1
vmv (%)	6.9	11.4	10.6	41.6	1.0	9.5	9.2
Llogaria Kapitale	36.6	55.4	98.0	50.5	96.1	113.8	9.5
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-154.6	-293.3	-199.7	-182.0	-14.4	-431.7	-223.2
Llogaria financiare	-98.5	-192.7	-242.1	-132.7	95.8	-339.4	-303.5
vmv (%)	1451.5	28.1	-9.7	-54.3	-197.3	76.1	25.4
/ PBB-së (%)	-2.9	-5.4	-7.2	-3.2	2.5	-8.3	-7.6
Investime direkte	-223.3	-219.8	-223.6	-226.5	-249.8	-290.1	-252.8
vmv (%)	-12.0	-11.5	0.9	-1.0	11.9	32.0	13.1
Investime portofoli	10.6	163.9	120.0	82.9	148.1	-434.9	126.4
Derivativë financiare	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.0	2.0
Investime të tjera	114.0	5.8	-213.0	128.2	-54.8	-341.0	-88.1
Mjetet e rezervës	0.3	-142.7	74.5	-117.3	252.4	726.6	-88.9
Gabime dhe harresa	56.1	100.5	-42.3	49.3	110.2	92.3	-80.3

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT dhe vlerësime të autorit.